



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Bashkia Lezhë, L. "Skënderbej", Sh. "Gjergj Kastrioti", 4501 Lezhë, Nr. Tel. 00355 215 22270, e-mail: f.frokaj@lezha.gov.al

V E N D I M

Nr. 166, Datë 10 /07/ 2017

Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2017-2019, dhe Buxhetit për vitin 2017 të Bashkisë Lezhë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore"; të ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore ", i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave nr.8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm"; të Udhëzimit të M.Financave nr.8, datë 13.01.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017"; të ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"; të VKM nr.1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin nga MB ZHRAU, te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes e kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit"; të VKM nr.915, datë 11.11.2015 "Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve, te bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve"; Këshillit të Bashkisë Lezhë, bazuar në projektin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V e n d o s i:

I.Miratimin e Buxhetit për vitin 2017, dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2017-2019 të Bashkisë Lezhë, si më poshtë:

I/I.Plani i të ardhurave për vitet 2017-2019 të Bashkisë Lezhë si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Të ardhurat e veta	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
I	Nga burimet e veta vendore	764,137	771,130	797,953
1	Të ardhurat tatimore/taksat	624,177	638,196	662,360
2	Të ardhurat jotatimore	139,960	132,934	135,593
II	Të trashëguara nga viti i mëparshëm	69,710	0	0
III	Nga burimet qendrore	491,775	504,422	517,407
1	Transferta e pakushtëzuar	281,182	289,617	298,306
2	Transferta Specifike	167,798	171,154	174,577
3	Transferta e kushtëzuar	42,795	43,651	44,524
IV	Transferta specifike trashëguara v.2016	85,013	0	0
	TOTALI	1,410,635	1,275,552	1,315,360

1.2. Plani i shpenzimeve sipas programeve dhe strukturës ekonomike për vitet 2017-2019:

Programet buxhetore		Në mijë/lekë		
		Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
P1	Planifikim Manaxhim Administrim	366,760	362,411	362,411
P2	Shërbimet publike	279,587	198,741	199,241
P3	Infrastruktura rrugore dhe transporti publik	268,043	233,185	263,570
P4	Arsimi parashkollor & parauniversitar	248,143	244,037	248,907
P.5	Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit	0	3,000	3,000
P.6	Strehimi dhe Shërbimet sociale	28,333	28,000	28,000
P.7	Kultura, Sportet, Turizmi dhe Rinia	60,507	44,172	45,054
P.8	Mbrojtja dhe siguria publike	63,936	65,246	66,521
P.9	Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave	16,908	16,974	17,474
P.10	Bujqësia dhe zhvillimi rural	68,418	69,786	71,182
	Fondi rezervë	5,000	5,000	5,000
	Fondi i Kontigjencës	5,000	5,000	5,000
TOTAL I SHPENZIMEVE		1.410.635	1,275,552	1,315,360

Shpenzimet sipas programeve buxhetore

mijë/ lekë								
vmërtimi	Paga + Sig.shoq.	Shpenzime Operative	Subven-sione	Transferta	Investime	Fondi Rezervë	Fondi i Kontigj.	TOTALI
Viti 2017	637,610	440,048	0	14,542	308,435	5,000	5,000	1,410.635
Viti 2018	626,981	324,843	0	6,237	307,491	5,000	5,000	1,275,552
Viti 2019	632,466	327,308	0	6362	339,224	5,000	5,000	1,315,360

Shpenzimet sipas strukturës ekonomike

1/3. Prioritetet e investimeve për vitet 2017-2019 sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2.Miratimin e Buxhetit për vitin 2017 të Bashkisë Lezhë, konkretisht:

2/1.Miratimin e planit të të ardhurave sipas pasqyrës nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2/2.Miratimin e detajimit të shpenzimeve nga të gjitha burimet për vitin 2017, sipas pasqyrave nr.3, 3/1, 3/2, 3/3, 3/4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2/3.Miratimin e investimeve kapitale sipas pasqyren nr.4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3.Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Lezhë, dhe institucioneve të varësisë për vitin 2017, i cili do të jetë 995 vetë, nga të këto :

- Punonjës që do të paguhen nga të ardhurat e veta të bashkisë 739 vetë.

- Punonjës që do të paguhet nga Transferta Specifike 243 vetë.
- Punonjës që do të paguhet nga Transferta e Kushtëzuar 13 vetë.

4. Punonjës me kontratë të përkohshme 100 vetë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrin efektet e tij për vitin 2017.

KRYETARI I KËSHILLIT

Kristian GJIDODAJ



Nr. Prot. _____, Datë 14.07.2017

Kryetari të Bashkisë Lezhë
Prefektit të Qarkut Lezhë
Degës së Thesarit Lezhë
Ministrisë së Financave
Arkivit Bashkisë



SEKRETARI I KËSHILLIT

Eraldo DEDA



PRIORITETET E INVESTIMEVE PËR VITET 2017-2019

PRIORITETE E INVESTIMEVE DHE BURIMET E FINANCIMIT PËR VITET 2017-2019						
Nr	IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE KAPITALE	BURIMI I FINANCIMIT TË MUNDSHËM	VLERA (Lek)	SIPAS VITEVE		
				2017	2018	2019
1	Rikonstruksion rruga Gjadër-Varreza, Zojs – Varreza, Gjadër	Buxheti i Bashkisë	6 700 000	x		
2	Rehabilitim dhe asfaltim rruga Barbulloje e Re	Buxheti i Bashkisë	29 100 000	x		
3	Rikonstruksion rruga Blinisht – Baçel	Buxheti i Bashkisë	32 700 000	x		
4	Sheshi i parkimit te autobuzeve, Terminali i Udhetareve, Lezhe	Buxheti i Bashkisë / FSHZH	2 414 000/ 106 462 295	x	x	
5	Qendra e Gruas dhe Femijes lagjja Shën-Tereza	Buxheti i Bashkisë / Opera Life	4 499 000/ 64 860 000	x		
6	Ujesjellesi i fshatrave Kallmet i Madh dhe Kallmet i Vogel	Buxheti i Bashkisë/ KFW - FSHZH	3 000 000/ 70 000 000	x	x	
7	Rikonstruksion i rruges ne Lagjen e Spitalit	Buxheti i Bashkisë	10 000 000	x		
8	Rehabilitim dhe asfaltim rruga Lalm i Ri	Buxheti i Bashkisë	18 885 000	x		
9	Blerje toke për varrezat e qytetit Lezhë	Buxheti i Bashkisë	30 000 000			
10	Ndërtimi i banjove publike në qytetin Lezhë	Buxheti i Bashkisë	4 000 000			
11	Rikonstruksion i rruges I EVP – Shenkoll - Superstrate	FZHR	41 000 000	x		
12	Rehabilitim kanal ujites Koterr – Dajc, Kallmet etj	FZHR	25 000 000	x		
13	Rikualifikim i Qendres se Qytetit Lezhe (Faza II)	FZHR	366 392 232		x	x
14	Asfaltim rruga Balldre - Torovice – Bent	FSHZH / FZHR	657 108 372	x	x	x
15	Rikualifikimi i qendrës Shëngjin	FZHR	318 482 188		x	x
16	Ndertimi i rruges kryesore Parkut Industrial (Unaza Veriore Qytetit)	FZHR / FSHZH	277 910 169	x	x	
17	Rikonstruksion i rruges kryesore te fshatit Manati	FZHR	140 801 839	x	x	
16	Rikonstruksion i rruges qender Kallmet - kisha Katolike	FZHR	16 525 716	x	x	
18	Rikonstruksion i rruges Manati – Barbulloje	FZHR	99 971 964	x	x	x
19	Rikualifikimi i fasadave sheshi "Gjergj Kastrioti" dhe shetitoret kryesore në Lezhë dhe Shëngjin	FZHR	163 990 610	x	x	x
20	Rikonstruksion i rrugës "Gentian Marku" (Piraj- Superstradë	FZHR	60 183 043	x	x	x

21	Rikonstruksion rruge Superstradë -Rrile – Hidrovor	FZHR	159 290 856		x	x
22	Rikruksion i rruges Rraboshte - Kallmet (Rruga e zallit)	FZHR	77 200 000	x	x	x
23	Rikonstruksion i rrugës Kodër-Balldre – Varreza	FZHR	35 000 000	x	x	
24	Sistemim Asfaltim Rruga Markatomaj- Superstrate	FZHR	35 318 206	x	x	
25	Çerdhe dhe Kopesht, Lagjja Beslidhja	FZHR / Donator	137 437 300	x	x	
26	Ndertim i Kopeshtit, Lagje Beslidhja, Faza II	FZHR	61 981 794	x	x	
27	Ujesjellesi i fshatrave Rraboshte dhe Merqi	KFW/ FSHZH	38 360 000		x	x
28	Ujesjellesi i fshatrave Kolsh, Patalej dhe Gryke.	KFW/ FSHZH	27 400 000		x	x
29	Rikonstruksion rruge te brendshme Gramsh dhe KUB	FZHR	60 000 000		x	x
30	Rikonstruksion i rruges Mabe – Barbullush	FZHR	60 000 000		x	x
31	Rikonstruksion i rruges Bagel - Krajen	FZHR	45 000 000		x	x
32	Rikonstruksion i rruges Tale 2	FZHR	10 000 000		x	x
33	Rikonstrukion i rruges Rrile – Mylte (Tale)	Buxheti i Bashkisë	12 000 000	x		
34	Blerje fidanë pyjor	Buxheti i Bashkisë	7 000 000	x	x	x
35	Blerje paisje	Buxheti i Bashkisë	1 784 000	x		
36	Rikonstruksion zyrash	Buxheti i Bashkisë	40 000 000		x	x
37	Blerje soba për ngrohje shkolla, kopështe dhe çerdhe	Buxheti i Bashkisë	1 902 000	x		
38	F.Vendosje dyer dritare në shkolla	Buxheti i Bashkisë	1 700 000	x		
39	Investime e projekte të vogla dhe blerje paisje	Buxheti i Bashkisë	3 014 000	x		
40	Rikonstruksion i rrugëve në lagjen *Sh.Tereza*	Buxheti i Bashkisë	8 000 000	x		
41	Ndriçim i rrugës Shëngjin-Kune	Buxheti i Bashkisë	4 000 000	x		

Tabela përmbledhëse e të ardhurave nga të gjitha burimet për vitin 2017-2019

Në mijë lekë

Nr	EMERTIMI	Plani 2016	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
I	Të ardhurat nga taksat	510,110	624,177	638,196	662,360
I.1	Taksa mbi pasurinë	100,530	127,847	130,415	133,023
a	Taksa mbi ndertesat	50,900	67,447	68,796	70,172
a.1	Biznes	34,450	51,447	52,496	53,566
a.2	Familje	16,450	16,000	16,300	16,606
b	Taksa mbi tokën bujqësore	42,600	42,600	43,452	44,321
c	Taksa truall	7,030	17,800	18,167	18,531
c.1	Biznes	4,950	15,720	16,046	16,367
c.2	Familje	2,080	2,080	2,122	2,164
I.2	Tatimi i thjeshtuar i fitimit	45,000	16,800	17,136	17,479
I.3	Taksa e kalimit drejtës pronësisë Pas. Paluajt.	17,500	10,000	10,200	10,404
I.4	Taksa e ndikimit infrast.nga ndërtimet e reja	310,000	420,000	430,000	450,000
I.5	Taksë tabele	4,630	9,230	9,418	9,606
I.6	Taksë reklame	8,200	5,500	5,595	5,707
I.7	Taksa e fjetjes në hotel	6,200	14,200	14,471	14,761
I.8	Taksa e regjistrimit të automjeteve	17,000	20,000	20,400	20,808
I.9	Renta minerale	950	500	510	520
I.10	Taksa të përkohshme	100	100	51	52
II	Të ardhurat jotatimore	153,463	139,960	132,934	135,593
II.1	Nga tarifat për shërbimet publike	81,200	80,930	73,584	75,056
II.1.1	Pastrimi e largimi i mbeturinave, ndriçim etj	77,090	75,590	70,014	71,414
a	Biznes	29,150	27,750	28,357	28,925
b	Familje	47,100	47,000	40,800	41,616
c	Institucione	840	840	857	874
II.1.2	Përdorimi pronave publike	200	2,500	2,550	2,601
II.1.3	Dhënie licenca,leje,autorizime etj.	3,910	1,000	1,020	1,040
II.2	Të ardhura të tjera	66,563	53,850	54,148	55,231
II.2.1	Nga veprimtaritë ekonomike	0	0	0	0
II.2.2	Nga qerat mbi trojet e ndërtesat	12,640	2,000	2,040	2,081
II.2.3	Kontribute, sponsorizime,donacione etj.	7,373	5,000	5,100	5,202
II.2.4	Nga gjobat	3,000	3,000	2,550	2,601
II.2.5	Të tjera	43,550	43,850	44,458	45,347
a	Tarifa e parkimit	1,150	2,000	2,040	2,081
b	Biblioteka	140	150	51	52
c	Muzeu	600	700	714	728
d	Tarifa e zënies hapësirave publike	13,580	28,200	28,750	29,325
e	Tarifat e urbanistikës	4,000	2,500	2,550	2,601
f	Tarifa e ujit të pijshëm	4,080	300	153	156

g	Të tjera(gj.civile,debitorë ndaj institucionit)	20,000	10,000	10,200	10,404
II.3	Të ardhura të tjera nga instituc. vartëse	5,700	5,180	5,202	5,306
II.3.1	Pagesat e prindërve për çerdhet	1,500	1,500	1,530	1,561
II.3.2	Pagesat e prindërve për kopështet	4,000	3,500	3,570	3,641
II.3.3	Pagesat e nxën.të shkollave të mesme	200	180	102	104
III.	Të trashguara nga viti i mëparshëm	35,092	69,710	0	0
A	Shuma e të ardhurave nga burimet e veta	698,665	833,847	771,130	797,953
	Transferta e pakushtëzuar	230,553	281,182	289,617	298,306
	Transferta Specifike	256,841	167,798	171,154	174,577
	Transfertë e Kushtëzuar	9,500	42,795	43,651	44,524
	Të tjera Tr.specifike&kushtëzuara trasheg.	0	85,013	0	0
B	Shuma e Transfertave	496,894	576,788	504,422	517,407
	TOTALI I BURIMEVE TË VETA	1,195,559	1,410,635	1,275,552	1,315,360

PËRMBLEDHËSE E PLANIT TË SHPENZIMEVE PËR VITIN 2017

000/lekë

Nr	TË ARDHURA - FINACIME	SHUMA	Nr	Nr. Prog.	PROGRAMI	SHPENZIMET DHE TË DALAT							
						TOTALI	600	601	602	604	651	230	231
I	TË ARDHURAT E VETA	764137	1	P.1	Planifikim-Menaxhim-Administrim	339616	227231	36280	85397	8427			1784
1	ARDHURAT TATIMORE	624177	2	P.2	Shërbimet Publike Vendore	279587	43584	6929	184074				45000
2	ARDHURAT JOTATIMORE	139960	3	P.3	Infrastruktura Rrugore Vendore e Rurale	268043	21539	3447	46260		11000		185797
-	ARDHURA NGA TARIFAT	80930	4	P.4	Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar	248143	137512	22577	73163	6115			8776
-	TË ARDHURAT E TJERA	59030	5	P.5	Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit	0							
3	DONACIONE	0	6	P.6	Strehimi dhe Shërbimet Sociale	28333			8834				19499
			7	P.7	Kultura,Sportet,Turizmi dhe Rinia	60507	47855	7612	5040				
II	TRANSFERTAT	491775	8	P.8	Mbrojtja Civile dhe Siguria Publike	63936	40658	6737	16541				
1	TRAN. E PAKUSHTËZUAR	281182	9	P.9	Mjedisi, Administrimi i Pyjeve & Kull.	16908	11970	1904	534				2500
2	TRANSFERTË SPECIFIKE	167798	10	P.10	Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	68418	18787	2988	12564				34079
3	TRANSF. E KUSHTËZUAR	42795			Fondi Rezervë	5000				5000			
					Fondi i Kontigjencës	5000				5000			
III	TË TRASHEGUARA	154723			Kuota Qarku 1 %	7641			7641				
1	TRANS. PAKUSHTËZUAR	61497											
2	TË ARDHURA	8213											
3	TRANSFERTË SPECIFIKE	40211											
4	TRANSF. E KUSHTËZUAR	44802											
5	DONACIONE												
TOTALI		1410635			TOTALI	1410635	549136	88474	440048	24542	11000	0	297435

PLANI I SHPENZIMEVE PËR INVESTIMEVE PËR VITIN 2017


000/lekë

Nr	Emërtimi	Nr. Prog.	TOTALI	Njësia Administrative
a	NGA GRANTI		125922	
	Investime në proçes		89851	
1	Rikonstruks. rruga Gjadër-Varreza, Zojs-varreza Gjadër	P.3	6700	Dajç
2	Rehabilitim dhe asfaltim rruga Barbullojë e Re	P.3	29100	Shënkoll
3	Rikonstruksion rruga Blinisht-Baçel	P.3	32700	Blinisht
4	Blerje soba për ngrohje, kopështe,shkolla, çerdhe	P.4	1902	Arsimi
5	F.Vendosje dyer dhe dritare në shkolla	P.4	1700	Zejmen, Shënkoll
6	Blerje paisje	P.1	1784	Lezhë
7	Investime të palikujduara në vite		15965	
	-Ndërtim Kopshti të Fëmijëve Lezhë	P.4	4500	Lezhë
	-Rikonstruk.&asfaltim rruga Kodërmarlekaç,Spitalit etj.	P.3	10500	Lezhë
	-Sistemim,asfaltim,ndriçim&gjebërim Bll.11. ² ha. F.II-të	P.3	965	Lezhë
	Investime parashikuara për vitin		36071	
1	Bashkëf. 10 %. KFW Ujësjeslesi Kallmet i Madh & Vogël	P.2	2414	Kallmet
2	Blerje mjete vetshkarkuese mbi 3.5 ton	P.2	2000	Lezhë
3	Blerje mjete vinç me krah mbi 10 m	P.2	2000	“
4	Investime e projekte të vogla dhe blerje paisje	P.3	3014	“
5	Blerje toke për varrezat e qytetit Lezhë	P.2	22643	“
6	Ndërtim i 2 banjove publike në qytetin Lezhë	P.2	4000	“
b	NGA TË ARDHURAT		92632	
1	Investime dhe projekte të vogla	P.3	717	Lezhë
2	Supervizione e kolaudime	P.3	1000	“
3	Bashkëfin.10 %.Opera Life Qendra e Gruas&Fëmijëve	P.6	4499	“
4	Bashkëf. 10 %. KFW Ujësjeslesi Kallmet i Madh & Vogël	P.2	586	Kallmet
5	Rikonstruksion i rrugës në lagjen e Spitalit	P.3	10000	Lezhë
6	Blerje toke për varrezat e qytetit Lezhë	P.2	7357	“
7	Rehabilitim dhe asfaltim rruga Lalm mi Ri	P.3	18885	Kolsh
8	Blerje kafshë pune (mushka)	P.9	500	Agj.Pyjeve
9	Blerje fidanë pyjor	P.9	2000	Lezhë
10	Blerje objekti për Qendrën e Zhvillimit Ditor faza e I-të	P.6	15000	Q.Zh.D Lezhë
11	Rehab. Sheshi, trotuari, rruge nga prishja obj.M.Dodës	P.3	5000	Lezhë
12	Blerje paisje për shkolla, kopështe dhe çerdhe	P.4	674	Arsimi
13	Rikonstrukion i rrugës Rrile –Mylte (Tale)	P.3	12000	Rrilë
14	Rikonstruksion i rrugëve në lagjen Sh.Tereza	P.3	8000	Lezhë
15	Ndriçim i rrugës Shëngjin-Kune	P.2	4000	Shëngjin

16	Bashkëf. 20 % . F.SH.ZH “Terminali Udhëtarëve Lezhë”	P.3	2414	Lezhë
c	NGA BUXHETI I SHETIT		78881	
1	Rehabilitim Lulishte dhe sheshi para Gjmnazit	P.3	3802	Lezhë
2	Skema e ujitjes Mat-Lezhë	P.10	24	Bujqësia
3	Rikonstruksioni rrugës I.E.V.P Shënkoll-Superstradë	P.3	41000	Shënkoll
4	Blerje eskavatori	P.10	9055	Bujqësia
5	Rehabilitim kanale ujitëse Kotërr-Dajç, Kallmet etj.	P.10	25000	Bujqësia
	TOTALI (a + b + c)		297435	

SHPENZIMET GJYQËSORE, SHPRONËSIME DHE KREDIA

Nr	Emërtimi	Nr. Prog.	TOTALI	
a	NGA GRANTI		34000	
1	Vendim Gjykate, pagesë për rrugë në qytetin Shëngjin	06260	23000	Shëngjin
2	Shpronësim për rrugën Kune-Shëtitorë, në Shëngjin	06260	1000	“
3	Shpronësim objekti të Marka Dodës, në qytetin Lezhë	06260	10000	Lezhë
b	NGA TË ARDHURAT		11000	
1	Kredia & Interesat (Financim rrugë, sheshe dhe trotuare)	651	11000	Lezhë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Bashkia Lezhë, L. "Skënderbej", Sh. "Gjergj Kastrioti", 4501 Lezhë, Nr. Tel. 00355 215 22270, e-mail: f.frokaj@lezha.gov.al

PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2017

DHE

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM

2017-2019

Përmbajtja

I.Mbi procesin e përgatitjes së Buxheti Afatmesëm të Bashkisë për vitet 2017-2019.

II.Të Ardhurat e Bashkisë për vitin 2017-2019

A. Të ardhurat e veta vendore

A.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

A.1.a Ngarkesa fiskale sipas njësive administrative

A.1.b Të ardhurat nga taksat vendore

A.1.c Të ardhurat nga tarifat vendore/jotatimore

A.1.d Gjobat dhe të ardhurat e tjera jo tatimore

A.2 Të ardhurat nga burimet qendrore

A.2.a Transferta e pakushtëzuar

A.2.b Transferta specifike sipas funksioneve

A.2.c Fondi i Zhvillimit të Rajoneve(FZHR)

A.2.d Transferta e kushtëzuar

III.Shpenzimet e Bashkisë për vitin 2017-2019

P. Programet e Zhvillimit të Bashkisë

P1.Planifikim, Menaxhim, Administrim

P2. Shërbimet Publike Vendore

P3.Infrastruktura Rrugore Vendore dhe Rurale

P4. Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar

P5. Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit

P6. Strehimi dhe Shërbimet Sociale

P7. Kultura, Sportet, Turizmi dhe Rinia

P8. Mbrojtja Civile dhe Siguria Publike

P9.Mjedisi dhe Administrimi i Pyjeve e Kullotave

P10.Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Aneksi 1: G.M.S (Grupi për Menaxhimin Strategjik)

Aneksi 2: Tabela e Programeve, Funksioneve dhe drejtuesit e Ekipit Menaxhimit të Programit (E.M.P)

Aneksi 3:Tabela përmbledhëse e të ardhurave

Aneksi 4: Fishat e kerkesave sipas projekteve

Aneksi 5: Baza ligjore



I. Mbi procesin e përgatitjes së Buxheti Afatmesëm të Bashkisë për vitet 2017-2019.

Mbas reformës territoriale Bashkia operon në një territor më të gjerë, pra vendosja e një ekuilibri eficient dhe të qëndrueshëm mes tyre kërkoi një vizion të qartë të bazuar në njohje kapilare të territorit dhe me mbështetje e kontribut aktiv dhe të vazhdueshëm nga institucionet vendore, qytetarët, bizneset, shoqëria civile, planifikuesit, etj.

Është pikërisht Strategjia e Ardhëshme e Zhvillimit të territorit të Lezhës, e cila tashme në përfundim, që shihet si lexim dhe mirëkuptim i kësaj shumëllojshmërie. Ky dokument i integruar dhe dokumentat e tjera strategjike, i shërbeu edhe procesit të planifikimit të integruar të PBA 2017-2019 dhe buxhetit të vitit 2017. Pra, Bashkia Lezhë, në procesin e planifikimit dhe përfitimeve të komunitetit, nuk shikohet si një bashkësi prej dhjetë njësisish administrative, por si një organizëm i vetëm ku çdo zonë ose grup popullate ka të njëjtat raporte me territorin dhe me administratën vendore.

Vizioni_Bashkisë Lezhë synon të bëhet:

- (i) platformë shkëmbimi dhe e kompletuar me logjistike mbështetëse për flukset kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave, energjisë dhe personave,
- (ii) qendër zhvillimi ekonomik tërheqës për investimet e huaja.
- (iii) qendër urbane policentrike e pjesëshme që ofron shërbime cilësore ndaj qytetarëve të saj, dhe të vizitorëve.

Politikat Strategjike ;

- Politika Strategjike 1: Lezha, platformë shkëmbimesh & nyje logjistike në shërbim të rajonit të Ballkanit dhe Europës Jug-Lindore.
- Politika Strategjike 2: Lezha atraktive për investitorët strategjike & motor zhvillimi ekonomik në Shqipëri.
- Politika Strategjike 3: Lezha për qytetarët. Bashkia Lezhë do të ofrojë shërbime efiçente, cilësore dhe gjithëpërfshirëse të fokusuara tek banorët.

Bazuar në këtë kuadër planifikimi, shpërndarja e burimeve është adresuar drejt politikave dhe qëllimeve të zhvillimit strategjik, të cilat orientojnë ;

- Ndërtimi e një strukturë urbane optimale që merr parasysh vendndodhjen dhe zhvillimin e poleve urbane, denësitetin e sipërfaqes së ndërtuar, sipërfaqeve të hapura & jeshile, dhe sistemet e transportit, etj;
- Përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe barazisë sociale për banorët e saj të ndërtuar në gamën e shërbimeve dhe të mirave materiale që i ofron ambienti urban qytetarëve si dhe aksesit të qytetarëve në to. Këtu mund të përmendim punësimin, shëndetin, arsimimin, kulturën, mbrojtjen sociale, dhe shërbimet e tjera për qytetarët, dhe vizitorët e qytetit.

Bashkia Lezhë përbëhet nga 10 njësi administrative (ish-bashkia Lezhë dhe 9 komunat). Ka dy qytete (Lezha dhe Shëngjini) dhe 65 fshatra. Ajo gjendet në veripërendim të vendit dhe kufizohet në veri me bashkitë Shkodër e Vau-Dejës, në lindje me bashkinë Mirditë, në jug me Bashkinë Kurbin dhe në përendim me detin Adriatik. Ka një sipërfaqe prej 456.⁸ km², ku rreth 65 % e saj është kodrinore e malore dhe 35 % e sipërfaqes është fushore. Popullsia sipas gjendjes civile është 108,519 banorë, ndërsa sipas Census-it është 65,633 banorë. Në qendrat urbane jetojnë rreth 40 % e popullsisë, ndërsa rreth 60 % e popullsisë jetojnë në zonën rurale. Degët bazë të ekonomisë së saj janë bujqësia, turizmi dhe tregtia. Në territorin e bashkisë zhvillojnë

aktivitet pothuajse të gjitha llojet e transportit, si ai rrugor, hekurudhor dhe detar. Në këtë terri-
tor është Porti Detar Shëngjinit dhe Airoporti Ushtarak i Gjadrit.

Bujqësia dhe Turizmi janë sektorët më prioritar të zhvillimit, krahas sektorëve të tjerë si pesh-
kimi, industria përpunimit drurit, materialeve të ndërtimit, tregëtisë dhe të shërbimeve.

Turizmi, krahas bujqësisë është një nga sektorët më në rritje e zhvillim, kryesisht ai bregdetar, i
cili zhvillohet në një vijë bregdetare prej 38 km. Krahas këtij turizmi një burim asetesh turistik
janë edhe trashëgimia arkeologjike, etno-kulturore, historike dhe burimet e tjera natyrore dhe të
tradiçës.

Ndarja në fshatra sipas Njërive Administrative të Bashkisë Lezhë

Bashkia Lezhë	Qytetet dhe Fshatrat
Nj.A Lezhë	Qyteti: Lezhë
Nj.A Shëngjin	Qyteti Shëngjin, Fshatra: Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhe, Mali-Rencit, Mali-Shën- gjin, Kodër Mulliri.
Nj.A Zejmen	Fshatra: Zejmen, Tresh, Pruell, Bërzane, Pllanë, Markatomaj, Spiten.
Nj.A Shënkoll	Fshatra: Shënkoll, Tale1, Tale 2, Barbullojë, Grykë-Lumi, Gajush, Alk, Rrilë.
Nj.A Balldre	Fshatra: Balldre i Vjetër, Mali-Kakarrriq, Qëndër-Kakarrriq, Balldren i Ri, Gocaj, Torovicë, Malecaj, Koljakaj.
Nj.A Kallmet	Fshatra: Kallmet i Madh, Kallmet i Vogël, Rraboshtë, Mërqi.
Nj.A Blinisht	Fshatra: Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajën, Piraj, Baqel, Kodhel.
Nj.A Dajç	Fshatra: Dajç, Gjadër, Gramsh, Mabë, Dragushë, Kotërr, Zojs.
Nj.A Ungrej	Fshatra: Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivaç, Rras i Butë, Sukaxhi, Fregen, Zimaj, Kaluer,
Nj.A Kolsh	Fshatra: Kolsh, Gjash, Kacinar, Patalej, Lalm, Lalm-Lukaj, Manati, Velë, Grykë- Manati, Barbullojë e Re
TOTALI	2 Qytete dhe 65 Fshatra

Hartimi i buxhetit për vitin 2017 dhe PBA 2017-2019 është realizuar bazuar në ligjin Nr.139/
2015, të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e
Shqipërisë”, të ligji Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhë-
zimit të Ministrisë së Financave Nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes
së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012
“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.4,
datë 29.02.2016 “Për hartimin buxhetor afatmesëm 2017-2019” si dhe shkresës së Ministrisë së
Financave nr.2995/8, datë 23.03.2016.

Sipas kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.4/1, datë 29.02.
2016, Kryetari i Bashkisë ka miratuar kalendarin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm
(PBA), duke përcaktuar veprimtarinë e punës së Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP), si
më poshtë vijon:

- U përcaktua struktura e programeve sipas funksioneve kryesore të përcaktuara në ligjin
nr.139/2015;
- Çdo Ekip i Menaxhimit të Programit u trajnuar dhe udhëzua në lidhje me zbatimin e pro-
cedurave të programit buxhetor afatmesëm duke përfshirë dhe ndihmën e eksperteve të dldp-së;
- U diskutua me drejtuesit e programeve për dokumentin e risqeve të paraqitur prej tyre

dhe përcaktimin e risqeve prioritare për t'u diskutuar në GMS;

- U përdoren formulare ndihmues për paraqitjen e kërkesave buxhetore për përdorim të brendshëm në lidhje me përcaktimin e Politikës së Programit dhe Planifikimin e Shpenzimeve të Programit;

- Prezantimin tek Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik të të gjithë dokumentacionit të kërkesave buxhetore dhe përzgjedhjen e prioriteteve për periudhën 2017-2019.

Për llogaritjen e nivelit të transfertës së pakushtëzuar jemi mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.4/1, datë 29.02.2016 me një rritje 3 % në çdo vit.

Përgatitja e PBA 2017-2019 u mbështet kryesisht:

- Në analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve të dy viteve, kryesisht të vitit 2015 dhe të pritëshmit të buxhetit 2016.

- Parashikimin e burimeve financiare për periudhën 2017-2019;
- Përcaktimin e tavaneve sipas çdo programi dhe funksioni (për tre vitet e ardhshme);
- Përzgjedhjen e prioriteteve të investimeve sipas fushave/programeve, duke shfrytëzuar strategjinë e territorit.

- Analizën dhe vlerësimin e projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike;

- Analizën e kontratave dhe shërbimeve publike, të mirëmbajtjes së objekteve arsimore, dhe administrative, rrugëve të brendshme dhe atyre rurale;

Për periudhën fillestare të planifikimit, pas reformës administrative territoriale, ka qenë e vështirë mbledhja dhe analizimi i të dhënave për planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve si rezultat i mungesës së bazës së të dhënave.

Formulimi dhe prezantimi i buxhetit të vitit 2017-2019 është risi përse i përket metodologjisë së hartimit, duke ndjekur me korrektësi në fakt zbatimin e detyrueshëm të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i orientuar drejt produktit për shërbime dhe zhvillim për banorët e bashkisë.

Planifikimi i buxhetit është bërë duke shfrytëzuar Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, e pikërisht Qëllimet dhe Objektivat strategjike të saj, drejt objektivave të programit, dhe treguesve të produkteve, aktiviteteve dhe kostos për periudhën e planifikimit.

Metodologjia e planifikimit e përdorur sipas skemës së mëposhtme, e bën këtë buxhet të lexueshëm dhe të monitorueshëm lehtësisht në çdo kohë, gjatë gjithë procesit të zbatimit, nga çdo kush; nga administrata vendore, nga këshilltarët vendore, nga organizatat e shoqërisë civile.

Bashkia mbi bazën e fushave të përcaktuara sipas ligjit Nr.139/2015 dhe funksioneve që janë përgjegjësi e bashkisë ka përcaktuar 10 programe buxhetimi.


Tabela e mëposhtme adreson fondet për çdo program sipas viteve 2017-2019 ;

mijë/lekë

	Programet buxhetore	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
P1	Planifikim Manaxhim Administrim	366,760	362,411	362,411
P2.	Shërbimet publike	279,587	175,179	175,679
P3.	Infrastruktura rrugore dhe transporti publik	268,043	290,285	321,339
P4.	Arsimi parashkollor & parauniversitar	248,143	244,037	248,907

P.5	Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit	0	3,000	3,000
P.6	Strehimi dhe Shërbimet sociale	28,333	28,000	28,000
P.7	Kultura, Sportet, Turizmi dhe Rinia	60,507	45,395	46,303
P.8	Mbrojtja dhe siguria publike	63,936	65,246	66,521
P.9	Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave	16,908	16,974	17,474
P.10	Bujqësia dhe zhvillimi rural	68,418	35,025	35,726
	Fondi rezervë	5,000	5,000	5,000
	Fondi i Kontigjencës	5,000	5,000	5,000
	TOTAL I SHPENZIMEVE	1.410.635	1,275,552	1,315,360

Tabela 1. Planifikimi sipas programeve buxhetore.




Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet janë sipas tabelës më poshtë;

mijë/ lekë

Emërtimi	Paga + Sig.shoq.	Shpenzime Operative	Subven-sione	Transferta	Investime	Fondi Rezervë	Fondi i Kontigj.	TOTALI
Viti 2017	637,610	440,048	0	14,542	308,435	5,000	5,000	1,410.635
Viti 2018	626,981	324,843	0	6,237	307,491	5,000	5,000	1,275,552
Viti 2019	632,466	327,308	0	6362	339,224	5,000	5,000	1,315,360

Tabela 2. Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik.



Sipas funksioneve, shpenzimet janë si më poshtë;

000/lekë

Nr	Programet buxhetore	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
1.	Administrata vendore;	359,412	354,386	354,225
2.	Arsimi parashkollor, parauniversitar, kopështe dhe çerdhe;	248,143	244,037	248,907
3.	Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane;	108,726	78,326	78,326
4.	Ndriçimi i mjediseve publike;	54,306	24,764	24,764
5.	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;	268,043	290,285	321,339
6.	Parqet, lulishtet dhe hapësirate gjelbërta publike;	20,000	20,000	20,000
7.	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;	33,000	3,000	3,000
8.	Shërbimi i dekorit publik;	3,000	3,000	3,000
9.	Emërgjencat Civile dhe administrimi i strukturave përkatëse;	37,210	37,986	38,715
10.	Shërbimi zjarrfikës dhe administrimi i strukturave përkatëse;	26,726	27,260	27,806
11.	Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;	23,008	7,148	7,291
12.	Zhvillimi, mbrojtja, dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetarëve;	8,151	8,314	8,480
13.	Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;	7,745	7,899	8,057
14.	Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;	12,225	12,469	12,718
15.	Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të mosshuarit etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;	3,102	3,000	3,000
16.	Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale;	19,499	20,000	20,000
17.	Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujtitjes dhe kullimit të tokave, si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;	60,709	27,162	27,706

18.	Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit, këshillimit bujqësor e rural,dhe kontrolli ushqimor sipas legjislacionit në fuqi;	7,709	7,863	8,020	
19.	Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimit e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;	16,908	16,974	17,474	
20.	Planifikimi, administrimi dhe kontrolli i territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;	0	3,000	3,000	
21.	Projekte dhe programe rinore;	0	0	0	
22.	Mbledhja dhe largimi i ujrave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara;	53,555	46,089	46,589	
23.	Prodhimi, trajtimi, transmetimi e furnizimi me ujë të pijshëm dhe largim të ujrave të zeza.	7,000	0	0	
24.	Zhvillimi i Turizmit;	9,378	9,565	9,757	
25.	Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, pagesë qiraje për pastrehët, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe formave të tjera të strehimit;	5,732	5,000	5,000	
26.	Shërbimi i Gjendjes Civile;	7,348	8,025	8,186	
	Fondi rezervë;	5,000	5,000	5,000	
	Fondi i kontingjencës;	5,000	5,000	5,000	
	TOTAL I SHPENZIMEVE	1,410.635	1,275,552	1,315,360	

Tabela 3. Planifikimi i buxhetit sipas funksioneve

Disa tregues të rëndësishëm për vitin 2017.

Në grupin e të ardhurave, të ardhurat nga taksat zënë pjesën më të rëndësishme, të cilat përbëjnë 81.7 % e të ardhurave nga burimet e veta, ndërsa shpenzimet me potenciale janë shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore që zënë 43.9 % të totalit të shpenzimeve.

Emertimi	Ne % ndaj totalit	PBA 2017-2019
1.Të ardhura nga taksat	Ndaj totalit të të ardhurave nga burimet e veta	81.7 %
2.Të ardhura nga tarifat	Ndaj totalit të të ardhurave nga burimet e veta	10.6 %
3.Të ardhura nga burime të tjera	Ndaj totalit nga burimet e veta vendore	7.7 %
4.Shpenzime kapitale	Ndaj totalit të shpenzimeve nga burimet e veta	20.6 %
5. Shpenzime operative	Ndaj totalit të shpenzimeve nga burimet e veta	36.6 %
6. Shpenzime paga &sigurime	Ndaj totalit të shpenzimeve nga burimet e veta	42.8 %

Tabela 4. Tabela e disa treguesve të vitit 2017.

II. Të Ardhurat e Bashkisë për vitin 2017-2019;

Sipas nenit 34, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpër-

drejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësive të vetëqeverisjes u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2017 të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Lezhë nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë **1,410,635** mijë lekë, në vitin 2018 ato rriten afërsisht me 1.⁶ %, ndërsa në vitin 2019 me 3.¹ % (duke përfshirë F.ZH.R dhe fondet e trashëguara).

Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash si më poshtë:


- a) **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifatat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore).
- b) **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja që i transferohen Bashkisë si dhe transfertat e kushtëzuar.

Kjo tabelë paraqet të ardhurat e bashkisë për vitin 2017-2019, sipas burimeve të financimit.

Në mijë lekë

Nr.	Të ardhurat e veta	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
I	Nga burimet e veta vendore	764,137	771,130	797,953
1	Të ardhurat tatimore/taksat	624,177	638,196	662,360
2	Të ardhurat jo tatimore	139,960	132,934	135,593
II	Të trashëguara nga viti i mëparshëm	79,668	0	0
III	Nga burimet qendrore	566,830	504,422	517,407
1	Transferta e pakushtëzuar	281,182	289,617	298,306
2	Transferta Specifike	167,798	171,154	174,577
3	Transferta e kushtëzuar	42,795	43,651	44,524
4	Investime nga Buxheti i Shtetit	75,055	0	0
	TOTALI	1,410,635	1,275,552	1,315,360

Tabela 5. Të ardhurat e Bashkisë për vitin 2017-2019 sipas çdo burimi



Të ardhurat nga burimet e veta vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave (të ardhurat tatimore dhe jotatimore), janë 764,137 mijë lekë dhe zënë 54.² % të totalit të të ardhurave gjithsej.

Raporti i të ardhurave nga burimet e veta ruhet me një rritje nga 1.⁶-3.¹ % në vitet 2018-2019, ndërsa transfertat e pakushtëzuar që akordohet nga Qeveria Qendrore ka një rritje prej 3 % çdo vit.

A. Te ardhurat e veta vendore;

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen për vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat është mbështetur në paketën fiskale të bashkisë, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e dety-

rimeve dhe agjentët tatimorë. Ndërsa niveli i transfertës së pakushtëzuar përcaktohet me ligj të vecantë nga Qeveria Qendrore.

Gjithashtu planifikimi i të ardhurave të veta u realizua si proces në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet dhe agjentët tatimorë, etj. Ky proces bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave të mundshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Tabela e mëposhtme paraqet të ardhurat e veta të bashkisë (të ardhurave nga burimet e veta, transfertën e pakushtëzuar dhe specifike) për vitin 2017-2019.

Në mijë lekë

Nr	EMERTIMI	Plani 2016	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
I	Të ardhurat nga taksat	510,110	624,177	638,196	662,360
I.1	Taksa mbi pasurinë	100,530	127,847	130,415	133,023
a	Taksa mbi ndertesat	50,900	67,447	68,796	70,172
a.1	Biznes	34,450	51,447	52,496	53,566
a.2	Familje	16,450	16,000	16,300	16,606
b	Taksa mbi tokën bujqësore	42,600	42,600	43,452	44,321
c	Taksa truall	7,030	17,800	18,167	18,531
c.1	Biznes	4,950	15,720	16,046	16,367
c.2	Familje	2,080	2,080	2,122	2,164
I.2	Tatimi i thjeshtuar i fitimit	45,000	16,800	17,136	17,479
I.3	Taksa e kalimit drejtës pronësisë Pas. Paluajt.	17,500	10,000	10,200	10,404
I.4	Taksa e ndikimit infrast.nga ndërtimet e reja	310,000	420,000	430,000	450,000
I.5	Taksë tabele	4,630	9,230	9,418	9,606
I.6	Taksë reklame	8,200	5,500	5,595	5,707
I.7	Taksa e fjetjes në hotel	6,200	14,200	14,471	14,761
I.8	Taksa e regjistrimit të automjeteve	17,000	20,000	20,400	20,808
I.9	Renta minerale	950	500	510	520
I.10	Taksa të përkohshme	100	100	51	52
II	Të ardhurat jotatimore	153,463	139,960	132,934	135,593
II.1	Nga tarifat për shërbimet publike	81,200	80,930	73,584	75,056
II.1.1	Pastrimi e largimi i mbeturinave, ndriçim etj	77,090	75,590	70,014	71,414
a	Biznes	29,150	27,750	28,358	28,925
b	Familje	47,100	47,000	40,800	41,615
c	Institucione	840	840	856	874
II.1.2	Përdorimi pronave publike	200	2,500	2,550	2,601
II.1.3	Dhënie liçenca,leje,autorizime etj.	3,910	2,840	1,020	1,040
II.2	Të ardhura të tjera	66,563	53,850	54,148	55,231
II.2.1	Nga veprimtaritë ekonomike	0	0	0	0
II.2.2	Nga qerat mbi trojet e ndërtesat	12,640	2,000	2,040	2,081
II.2.3	Kontribute, sponsorizime,donacione etj.	7,373	5,000	5,100	5,202
II.2.4	Nga gjobat	3,000	3,000	2,550	2,601
II.2.5	Të tjera	43,550	43,850	44,458	45,347
a	Tarifa e parkimit	1,150	2,000	2,040	2,081
b	Biblioteka	140	150	51	52

c	Muzeu	600	700	714	728
d	Tarifa e zënies hapësirave publike	13,580	28,200	28,750	29,325
e	Tarifat e urbanistikës	4,000	2,500	2,550	2,601
f	Tarifa e ujit të pijshëm	4,080	300	153	156
g	Të tjera(gj.civile,debitorë ndaj institucionit)	20,000	10,000	10,200	10,404
II.3	Të ardhura të tjera nga instituc. vartëse	5,700	5,180	5,202	5,306
II.3.1	Pagesat e prindërve për çerdhet	1,500	1,500	1,530	1,561
II.3.2	Pagesat e prindërve për kopështet	4,000	3,500	3,570	3,641
II.3.3	Pagesat e nxën.të shkollave të mesme	200	180	102	104
III.	Të trashguara nga viti i mëparshëm	35,092	69,710	0	0
A	Shuma e të ardhurave nga burimet e veta	698,665	833,847	771,130	797,953
	Transferta e pakushtëzuar	230,553	281,182	289,617	298,306
	Transferta Specifike	256,841	167,798	171,154	174,577
	Të tjera Tr.specifice&kushtëzuara trashgeg.	0	85,013	0	0
B	Shuma e Transfertave	487,394	533,993	460,771	472,883
	TOTALI I BURIMEVE TË VETA	1,186,059	1,367,840	1,231,901	1,270,836

Tabela 6. Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë Lezhë për vitin 2017-2019

A.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore;

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifrat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore, parashikimi i te cilave është mbështetur në paketën fiskale të miratuar nga këshilli i bashkisë, i cili përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Sipas nenit 35 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, mbledhjen dhe administrimin e tyre, brenda kufijve dhe kriterëve të përcaktuara me ligj si dhe krijojnë të ardhura nga tarifrat për shërbimet publike dhe veprimtaritë e tjera.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet edhe në:

1. Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920, datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë Nr.124, datë 15.04.2016 “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Lezhë”, i ndryshuar.

Në planifikimin e të ardhurave 2017-2019, bashkia u mbështet në realizimin e të ardhurave të vitit 2015 dhe në realizimin e pritshëm të vitit 2016. Për vitin 2017 të ardhurat janë parashikuar të jenë 103,687 mijë lekë më shumë se plani i vitit 2016.

Tabela e mëposhtme pasqyron të ardhurat e planifikuara nga burimet e veta sipas 4 kategorive (nga taksat, nga tarifrat, nga institucionet në vartësi dhe të ardhurat e tjera jotatimore si gjobat, qeratë, parkimi, zënia e hapësirave publike etj) , të cilat janë 764,137 mijë lekë për vitin 2017. Ato janë parashikuar me një trend rritje 2.2 % çdo vit për vitet 2018 - 2019. Pjesën më të rëndësishme prej 624,177 mijë lekë për vitin 2017 e përbëjnë të ardhurat nga taksat.

Nr	LLOJET E TE ARDHURAVE	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
A	SHUMA E TË ARDHURAVE TË VETA	764,137	771,130	797,953
a	Të ardhurat nga taksat vendore/tatimore	624,177	638,196	662,360


b	Të ardhurat nga tarifatat për shërbimet publike/jo tatimore	80,930	73,584	75,056
c	Të ardhurat nga institucionet në vartësi/jo tatimore	5,180	5,202	5,306
d	Të ardhurat e tjera jo tatimore	53,850	54,148	55,231

Tabela 7. Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për vitet 2017-2019 (000/ lekë)

Bazuar në strukturën e të ardhurave të veta sipas tabelës së mëposhtme, të ardhurat nga taksat vendore të cilat zënë 81.7 % të shumës të të ardhurave nga burimet e veta ose 44.2 % të totalit të ardhurave të Bashkisë nga të gjitha burimet.

Nr	SHUMA TE ARDHURAT NGA BURIMET E VETA	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
I	Të ardhurat nga taksat vendore/tatimore	624,177	638,196	662,953
	Ne % nda totalit	44.2%	47.1%	47.5%
	Ne % ndaj burimeve te veta	81.7%	82.8%	83.0%
II	Të ardhurat jo tatimore	139,960	132,934	135,593
	Ne % nda totalit	9.9%	9.8%	9.7%
	Ne % ndaj burimeve te veta	18.3%	17.2%	17.0%

Tabela 8. Struktura ne % e te ardhurave nga burimet e veta të bashkisë për vitet 2017-2019 (000/ lekë)



Struktura e të ardhurave sipas llojeve, nga burimet e veta, viti 2017

Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet në të gjitha njësitë administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë marrë të dhënat për taksapaguesit e një viti më parë, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të vitit 2016 me ndryshimet përkatëse të miratuar nga këshilli i bashkisë.

Në total numri taksapaguesve është parashikuar për 22543 familje, 2563 biznese dhe 25 institucione, ku peshën më të rëndësishme të taksapaguesve si numër e përbëjnë familjet me rreth 89 % ndaj totalit të taksapaguesve gjithsej.

i. Taksapaguesit familjarë

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale në bashki është 22,543 familje. Numri i familjeve në njësinë administrative Lezhë zënë peshën kryesore me 6,895 familje ose 30.6 % të numrit të përgjithshëm të familjeve në bashki. Familjet e njësive të tjera administrative bashku janë 15,648 familje, që zënë 69.4 % të totalit të famil-

jeve. Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafëruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente.

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si për familjet që janë përfitues të ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët etj, të cilët përbëjnë rreth 7,950 familjeose 35.³ % të familjeve taksapaguese.

Numri i familjeve taksapaguese sipas Nj.Administrative;

Nr	Taksapaguesit	Totali i Familjeve	Familje me taksa/tarifa të plota	Pensionistë, invalidë, familjet që nuk taksohen	Nga këta sa:	
					Të sëmurë, paraplegjik, tetraplegjik, të verbër, etj.	Përfitues të Ndihmës Ekonomike
1	NjA Lezhë	8,984	6,895	2,088	112	338
2	NjA Shëngjin	3,399	2,988	411	55	87
3	NjA Zejmen	2,526	1,700	826	35	157
4	NjA Shënkoll	4,879	2,400	2,479	74	195
5	NjA Balldre	2,682	2,200	482	36	108
6	NjA Kallmet	1,720	1,500	220	30	96
7	NjA Blinisht	1,515	1,060	455	24	29
8	NjA Dajç	1,922	1,600	322	22	36
9	NjA Ungrej	977	600	377	6	346
10	NjA Kolsh	1,891	1,600	290	38	198
	Bashkia Lezhë	30,495	22,543	7,950	432	1,590

Tabela 9. Nr.familjeve taksapaguese sipas Nj.Administrative

ii. Taksapaguesit biznese dhe institucione.

Bazuar në rregjistrat aktual, në total numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Lezhë është 2,563. Biznesi i vogël zë 82 % të numrit total të bizneseve.

Numri i institucioneve që përfshihen në detyrimet fiskale janë 25, ndër të cilat rreth 80 % e tyre ndodhen në Njësinë Administrative Lezhë.

Bizneset dhe institucionet janë të përqëndruara në Nj.A Lezhë dhe Shëngjin rreth (77 %). Bizneset e vogla janë rreth 2,101 biznese dhe kanë peshën më të rëndësishme taksapaguese, ato zënë rreth 82 % të numrit të bizneseve dhe institucioneve.

A.1.b Të ardhurat nga taksat vendore;


Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njëjësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Këto të ardhura janë planifikuar me një rritje mbi 2 % çdo vit. Përbëjnë 44.² % të totalit të ardhurave (të hyrave) ose 81.⁷ % të shumës të të ardhurave nga burimet e veta.

E ARDHURAT NGA BURIMET E VETA	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
Te ardhurat nga taksat vendore/Tatimore	624,177	638,196	662,360
Ne % nda totalit	44. ²	47. ¹	47. ⁵
Ne % ndaj burimeve te veta	81. ⁷	82. ⁸	83. ⁰

Tabela 10. Struktura e të ardhurave nga taksat vendore sipas viteve.

Pjesë e rëndësishme e ndikimit në këtë kategori janë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, e cila zënë 67.3 % të totalit të kësaj kategorie dhe taksa mbi pasurinë që zë 20.4 %.



Grafiku. Struktura e të ardhurave nga taksat për vitin 2017 në mijë lekë.

Të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Sipas ligjit nr.142/2015, “Për disa shtesa e ndryshime me ligjin nr.9632, datë 30.08.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 11, ndryshon dhe përcakton se:

- Shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 0-5 milion është 0 lekë; ndërsa shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 5 milion deri në 8 milion është 5 % e fitimit.

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1 % të vlerës së grumbulluar, ndërsa 99 % kalon në favor të bashkisë.

Parashikimi i të ardhurave për vitet 2007-2019 është bërë në një rritje prej 2 % nga viti në vit.

000/lekë

Të ardhura	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019
Nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për B. Vogël	16,800	17,136	17,479

Tabela 12. Të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël për vitet 2017-2019 në (000/ lekë)

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihet: a) taksa mbi ndërtesën, b) taksa mbi tokën bujqësore dhe c) taksa mbi truallin

a) Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas

ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Gjatë vitit parashikohet zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim;
- ndarjes në këste të pagesave;
- krijimit të arkave funksionale të agjentit tatimor më pranë zonave të banuara në njësitë administrative.

Në mungesë të të dhënave, deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqës së ndërtesës, detyrimi vjetor i taksës së ndërtesës është;

i. **Për familjet**, llogaritet për një sipërfaqemesatare prej 100 m² për të gjitha njësitë administrative dhe nuk është bërë diferencimi i banesave para dhe pas vitit 1993.


	Kategoritë e Ndërtesave të Banimit	NjA Lezhë			NjA të tjera			Total Të Ardhurat 000/lekë
		Nr. i familjeve	Niveli i taksës lek/m ²	Të ardhura 000/1	Nr. i familjeve	Niveli i taksës l/m ²	Të ardhura 000/lekë	
a)	Ndërtuar para vitit 1993	3,800	10	3,800	9,968	5	4,984	8,784
b)	Ndërtuar pas vitit 1993	3,000	12	3,600	5,680	6	3,408	7,008
	Shtëpi të dyta para 1993	50	20	100	0	10	0	100
	Shtëpi të dyta pas 1993	45	24	108	0	12	0	108
	Totali	6,895		7,608	15,648		8,392	16,000
	Në % / burimeve të veta			1 %			1. ¹ %	2. ¹ %

Tabela 13. Të ardhurat nga taksë vendore mbi ndërtesat e banimit për vitin 2017 në (000 lekë)

ii. Për ndërtesat e tjera për biznesin, detyrimin për taksën mbi ndërtesën e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme. Politike e Bashkisë është ulja me 20 % e nivelit ligjor për ndërtesat e biznesit.

Viti 2017		NjA Lezhë			NjA të tjera			Total te ardhura 000/leke	Totali i Sipërf. (m ²)
Kategoritë e Ndërtesave të biznesit	Sipërf. m ²	Niveli taksës l/m ²	Të ardhura 000/lek	Sipërf. m ²	Niveli taksës l/m ²	Të ardhura 000/lek			
a)	Tregti e shërbime	140,807	250	35,202	76,117	140	10,656	45,858	216,924
b)	Të tjera	29,034	150	4,355	17,632	70	1,234	5,589	46,666
	Totali	169,841		39,557	93,749		11,890	51,447	263,590
	Në % / totalit							6.⁷%	

Tabela 14. Të ardhurat nga taksë vendore mbi ndërtesat e biznesit, viti 2017, në (000 lekë)



Plani i të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat për vitet 2017-2019, në (000 lekë)

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat sipas taksapaguesve për vitet 2017-2019.

Kategorizimi	Parashikimi 2017 (000 lekë)	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)
Biznesi	51,447	52,496	53,566
Familjarët	16,000	16,300	16,606
TOTALI	67,447	68,796	70,172


Tabela 15. Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat sipas taksapaguesve për vitet 2017-2019 në (000 lekë)

b) Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore:

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në ha, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Për vitin 2017 do të taksohet një sipërfaqe prej 15,199 ha tokë dhe do të sigurohen 42,600 mijë lekë.

Kategorite e tokës bujqësore	Për të gjitha Nj.Administrative		
	Sipërfaqja ha	Niveli i taksës lekë/m ²	Të ardhura 000/lekë
I	600	3,920	2,352
II	2,050	3,430	7,032
III	8,084	2,940	23,766
IV	2,455	2,520	6,186
V	535	2,100	1,159
VI	535	1,680	898
VII – X	940	1,260	1,184
Totali	15,199		42,600
Ne % / Totalit			5.6%

Tabela 16. Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore për vitet 2017-2019, në (000 lekë)



Grafiku. Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore për vitet 2017-2019, në (000 lekë)


c) Të ardhurat nga taksa mbi truallin;

Truall është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të. Në këtë kategori do të bëjë pjesë e gjithë sipërfaqja jashtë ndërtesës në funksion të saj; në ato raste kur ajo është në shërbim të prodhimit, tregtimit, magazinimit, riciklimit dhe kur shfrytëzohet për parkim, rrugë, ambiente rekreative nga subjektet e biznesit të madh.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Niveli i taksës është ai sipas ligjit, për individët 0.56 lekë/m² dhe biznesin 20 lekë/m².

Kategorizimi	Sipërfaqja m ²	Niveli Lekë/m ²	Parashikimi 2017 (000/l)	Parashikimi 2018 (000/l)	Parashikimi 2019 (000/l)
Familjarët	28,071,000	0.56	15,720	16,046	16,367
Biznesi	104,000	20	2,080	2,122	2,164
TOTALI			17,800	18,167	18,531

Tabela 17. Të ardhurat nga taksa e truallit sipas taksapaguesve për vitet 2017-2019, në (000 lekë).



Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e këtyre taksave për vitin 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë me një rritje prej 2 % në çdo vit si më poshtë:

Të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel administrohet nga bashkia. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj. Detyrimi për taksën i takon

klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.

Kategorizimi	Njesia	Niveli lekë m ²	Parashikimi 2017 (000/l)	Parashikimi 2018 (000/l)	Parashikimi 2019 (000/l)
Hotel me 4-5 yje	Lekë/natë fjetje	140	0	0	0
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimit të ligjit për turizmin	Lekë/natë fjetje	70	14,200	14,471	14,761
TOTALI			14,188	14,471	14,761

Tabela 18. Të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel sipas kategorive për vitet 2017-2019 në (000 lekë)

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar me ligjin nr.107/2015 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, neni 39 dhe 46, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja jopublike është parashikuar si më poshtë:

	Natyra e Lejave të ndërtimit	Niveli
1.	1.a Ndërtime për njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo për përdorim publik.	6% e çmimit të shitjes
	1.b Për ndërtime për qëllime banimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është	4% e çmimit të shitjes
2.	Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1	3% e vlerës së investimit
3.	Leje ndërtimi për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte	0,1% e vlerës së investimit
4.	Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi	0,5% e vlerës së investimit

Tabela 19. Specifikime për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë me një rritje prej 2.⁴ %, në vitin 2018 dhe 4.⁶% në vitin 2019, si më poshtë:

Emërtimi	Parashikimi 2017 (000/l)	Parashikimi 2018 (000/l)	Parashikimi 2019 (000/l)
Taksa e ndikimit infrastrukturës	420,000	430,000	450,000

Tabela 20. Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitet 2017-2019 në (000/

Struktura e ngarkuar për planifikimin dhe vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë.

Të ardhurat nga taksa mbi kalimin e pronësisë për pasurinë e paluajtshme

Taksa me nivelet sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat e të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3 % të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Taksa mbi kalimin e së drejtës mbi pronësinë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

Emërtimi	Njësia	Për NjA Lezhe	Për NjA Tjera
Ndërtesa banimi	Lekë/m2	300	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	Lekë/m2	700	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m2	500	200

Tabela 21. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë.

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë në një rritje prej 2 % në çdo vit si më poshtë:

Emërtimi	Parashikimi 2017 (000/l)	Parashikimi 2018 (000/l)	Parashikimi 2019 (000/l)
Taksa mbi kalimin e drejtës së pronësisë	10,000	10,200	10,404

Tabela 22. Të ardhurat nga taksa mbi kalimin e pronësisë për pasurinë e paluajtshme për vitet 2017-2019 (000/l)

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë.

Të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura

Bazuar në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.

Referuar pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr.9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor. Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit të transportit rrugor.

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë me një rritje prej 2 % në çdo vit si më poshtë:

Emërtimi	Parashikimi 2017 (000/l)	Parashikimi 2017 (000/l)	Parashikimi 2019 (000/l)
Taksa e mjeteve të përdorura	20,000	20,400	20,808

Tabela 23. Të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura për vitet 2017-2019 në (000/lekë)

Të ardhura nga taksa e rentës minerare

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe / ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është dega e doganës në rreth. Ngarkohet për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5 %) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Lezhë në llogarinë e Degës së Thesarit.

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza, dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë në një rritje prej 2 % në çdo vit si më poshtë:

Emërtimi	Parashikimi 2017 (000/l)	Parashikimi 2018 (000/l)	Parashikimi 2019 (000/l)
Taksa e Rentës Minerare	500	510	520

Tabela 24. Te ardhura nga taksa e rentes minerarae per vitet 2017-2019

Të ardhurat nga taksa e tabelës dhe reklamës

Bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

Tabela për qëllime identifikimi, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.

Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.

Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillohet aktiviteti, në hapësira të tjera publike ose private që shërbejnë për qëllime reklamimi. Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë me një rritje rreth 2 % në çdo vit si më poshtë :

Kategoritë	Plani 2017 (000/l)	Plani 2018 (000/l)	Plani 2019 (000/l)
a) Për qëllime identifikimi	9,230	9,418	9,606
b) Për qëllime reklamimi	5,500	5,595	5,707

Tabela 25. Të ardhurat nga taksa e tabelës për vitet 2017-2019 në (000 lekë)

A.1.c Të ardhurat nga tarifat vendore/jotatimore;


Referuar ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura

nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Tabela e mëposhtme pasqyron të ardhurat nga tarifat për vitin 2017-2019, sipas llojit të shërbimeve që bashkia do të ofrojë për qytetaret, bizneset apo institucionet. Këto të ardhura përbëjnë 9.8 % e totalit të të ardhurave gjithsej ose 18-17 % e të ardhurave nga burimet e veta.

Emërtimi	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
TE ARDHURA NGA TARIFAT/JOTATIMORE	139,960	132,934	135,593
Ne % ndaj totalit	9.9	9.8	9.7
Ne % ndaj burimeve te veta	18.3	17.2	17.0

Tabela 26. Të ardhurat ne total nga tarifat për vitet 2017-2019



Nëse i referohemi strukturës të të ardhurave nga tarifat, pjesë e rëndësishme janë të ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike, të cilat zënë 57 % të totalit nga kjo kategori.

Të ardhurat nga tarifa e shërbimeve publike (pastrimi).

Tarifës së shërbimeve publike i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë / juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të bashkisë. Nivelet, baza e tarifave, kategoritë, nënkategoritë janë kompetencë e plotë e këshillit të bashkisë.

Në tarifën e shërbimeve publike, përfshihen të gjitha shërbimet e ofruara nga bashkia të tilla si, pastrimi dhe largimi i mbetjeve, gjelbërimi, ndriçimi dhe dekori.

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim. Politika e bashkisë synon në mbulimin e koston së shërbimeve. Pjesa më e madhe e koston ofrohet për Nj.Ad.Lezhë e

më pas për Nj.A Shëngjin, pra bizneset dhe familjet në këto njësi do të përballojnë edhe pjesën me të madhe të kostos.

Në bashki 62 % e kostos së pastrimit e mbulojnë familjet dhe 38 % bizneset dhe institucionet. Tarifa e llogaritur sipas kësaj metodologjie është për mbulimin 100 % të kostos, por tarifa e propozuar në paketën fiskale është me një ulje gati 25-30 % për përdoruesit e shërbimeve publike.

Ngarkesa e tarifimit është shpërndarë duke u bazuar në:

a) vendndodhjen (bashkia është ndarë në 3 zona, ku zona C ka tarifa me të ulta)

- Zona A ka këtë shtrirje: Godina Nj.A Kolsh, qyteti Lezhë, mbikalimi i shinave të trenit, ura e Drinit (Lezha Petrol), Nj.A Shëngjin, Kodër Marlekaj, Pusi i Shytit, varrezat e qytetit.

- Zona B: Nj.A Balldre, Nj.A Kolsh, Nj.A Zejmen, Nj.A Shënkoll.

- Zona C: Nj.A Dajç, Nj.A Blinisht, Nj.A Ungrej, Nj.A Kallmet.

b) llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, aktivitet transporti, ndërtimi, karburant, institucion, O.J.F, etj)

c) dhe në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulancë etj).

Për familjet në nevojë si më poshtë ka lehtësi fiskale:

Nuk do të paguajnë tarifën e mësipërme :

- Përfituesit e ndihmës ekonomike;
- Kryefamiljarë pensionistë të vetëm dhe me persona madhorë në ngarkim të papunë;
- Familje që kanë kryefamiljarin invalid;
- Familje që kanë në përbërje të tyre të verbër, paraplegjikë dhe tetraplegjikë;


Për Bizneset (niveli i tarifës mesatare është i detajuar sipas xhiros dhe zonave).

Për kategorinë e subjekteve fizike ose juridike, që ushtrojnë aktivitet jo fitim prurës si fondacione vendase ose të huaja, të regjistruara si të tilla në gjykatë, niveli për këtë tarifë do të jetë 10,000 lekë/vit.

Bazuar në nivelet e tarifave sipas paketës fiskale të miratuar në këshill, të ardhurat nga tarifa për shërbimet publike, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Viti 2017(000/l)	Viti 2018(000/l)	Viti 2019(000/l)
Biznesi	27,750	28,358	28,925
Familjarët	47,000	40,800	41,616
Institucionet	840	857	874
TOTALI	75,590	70,014	71,414

Tabela 27. Të ardhurat nga tarifa e shërbimeve publike, vitet 2017-2019 në (000 lekë)



Të ardhurat nga tarifa për shërbimet administrative;

Në këtë tarifë kemi parasysh shërbimet që ofrohen nga sektorët brenda bashkisë.

i. Nga tarifat për urbanistikë, vërtetime, autorizime, dokumenta të tjera;

Tarifat e miratuara janë si më poshtë:

1.Vërtetime për tender	200 lekë
2.Azhornime për reklama e zënie hapësira publike	2000 lekë
3.Pranim dosje për shqyrtim dhe aplikim për:	
– Për nevoja biznesi	5,000 lekë
– Për shtëpi banimi	2,000 lekë
– Pë ndryshim destinacioni	2,000 lekë
4.Për fasadën e objekteve	30 lekë/m ²
5.Kontroll i piktimit të objekteve	2,000 lekë/kontroll
6.Kotroll paspërfundimit të themeleve	5,000 lekë/kontroll
7.Kontroll pas përfundimit të karabinasë	2,000 lekë/kontroll
8.Kontroll mbi sistemimin e ambientit rrethues	3,000 lekë
9.Atkkontroll i përfundimit të punimeve për leje përdorimi	50 lekë/m ²
10.Azhornim genplanesh për leje ndërtimi	40 lekë/m ²
11.Matje dhe përcaktimi i zonës së vendndodhjes së objektit	3,000 lekë/d
12.Pranim kërkesë për punime riparimi në ndërtim, lëshim deklaratë punimesh,etj.	5000 lekë+3 % vl.preven.

Tabela 28. Tarifat urbanistikës dhe shërbimeve administrative

Nivelet e kësaj tarife për vitet 2017-2019 janë;

Emërtimi	Viti 2017 (000/l)	Viti 2018 (000/l)	Viti 2019 (000/l)
Tarifa për shërbimet administrative	3,500	3,570	3,641

Tabela 29. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve administrative për vitet 2017-2019 në (000/lekë)

ii. Nga tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura;

Tarifat e parashikuara për shërbimet veterinare janë parashikuar si më poshtë:

Nr.	Llojet e tarifave	Tarifa e shërbimit në lekë
I	Tarifa për çdo bagëti të therur	
	1. Për lopë, ka, buall	100
	2. Për viça dhe derra	100
	3. Për bagëti të imta	50
II	Shërbimi për veterinari për kontrollin	
	4. Kontrolli i peshkut për çdo parti	100

Tabela 30. Tarifa e shërbimit veterinar

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2017(000/l)	Viti 2018 (000/l)	Viti 2019 (000/l)
Tarifa e shërbimeve veterinare	100	105	110

Tabela 31. Të ardhurat nga tarifa e shërbimit veterinar

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është sektori i shërbimit veterinar.

iii. **Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit, autorizime etj;**

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016, parashikimi i të ardhurave për vitet 2017-2019 është bërë si më poshtë:

Emërtimi	V.2017 (000/l)	V.2018 (000/l)	V.2019 (000/l)
Tarifa për leje transporti	850	892	936

Tabela 32. Të ardhurat nga tarifa për dhënien e lejeve të transportit për vitet 2017-2019 në (000 lekë)

iv. **Nga tarifat e parkimit për mjetet e licënuara dhe tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë;**

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016 parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë si më poshtë:

Emërtimi	Baza	Niveli Lek/ditë	V. 2017 (000/l)	V.2018 (000/l)	V.2019 (000/l)
Tarifë Parkimi			700	735	771

Tabela 33. Të ardhurat nga tarifa e parkimit për vitet 2017-2019 në (000 lekë)

Nga tarifa për shërbimin në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj;

Sipas nenit 36, të ligjit 139/2015, bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Të ardhurat nga këto tarifa në total janë 5,180 mijë lekë për vitin 2017, dhe parashikohen kryesisht të mbulojnë kostot administrative të shërbimeve që bëhen në kopshte e çerdhet. Sektori i Financës është struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifave të kopshteve dhe çerdhe;

Emërtimi	V.2017 (000/l)	V.2018 (000/l)	V.2019 (000/l)
Të ardhura nga kopshte çerdhe	5,000	5,100	5,202
Të ardhura nga konvikti	180	102	104
TOTALI	5,180	5,202	5,306

Tabela 34. Të ardhurat nga veprimtari e kopshteve dhe çerdheve.

Të ardhurat nga tarifa e zënies së hapësirave publike;

Në përputhje me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kësaj tarife i nënshtrohen të gjitha subjektet të cilat shfrytëzojnë hapësirat publike për qëllimi fitimi. Subjektet duhet të vetë deklarojnë numrin e tavolinave që kanë vendosur në këto hapësira.

Këto subjekte ndahen në dy kategori:

1. Subjekte që shfrytëzojnë hapësirën publike në qytetet Lezhë dhe Shëngjin me 300 lekë në muaj
2. Subjekte që shfrytëzojnë hapësirën publike jashtë qyteteve me 150 lekë në muaj.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është sektori i taksave dhe i tarifave pranë bashkisë përkatësisht specialisti që mbulon subjektet që kërkojnë ushtrimin e kësaj të drejte, specialist i biznesit të vogël.

i. **Të ardhura nga tarifat për subjektet që përdorin hapësirat publike;**

Të gjitha bizneset që përdorin hapësirën publike paguajnë dyfishin e tarifës. Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016 parashikimi për vitet

2017-2019 është bërë si më poshtë:

Emërtimi	V.2017 (000/l)	V.2018 (000/l)	V. 2019 (000/l)
Tarifa e hapësirës publike	28,200	28,750	29,325

Tabela 35. Të ardhurat nga tarifa e zënies së hapësirave publike për vitet 2017-2019 në (000 lekë)

Të ardhura nga dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj;

Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga bashkia, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj.

Nr	Emërtimi	Njësia	Niveli tarifës
1	Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve dhe vajrave lubrifikanteme pakicë për 5 vjet.	Lekë/liçen	2,000,000
2	Dhënia e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për përdorim nga konsumatorët fundor.	Lekë/liçen	200,000

Tabelë 36. Dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës: Drejtoria e Shërbimeve Publike përcjell informacionin tek Sektori i të Ardhurave. Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës është Sektori i të Ardhurave.

A.1.d Gjobat dhe të ardhura të tjera jotatimore ;

Referuar ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36, pika 2, bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet.

i. Dhënia me qira e aseteve ;

Tek ky zë parashikohen të ardhurat prej 2,000 mijë lekë për vitin 2017, 2,040 mijë lekë për vitin 2018 dhe 2,081 mijë lekë për vitin 2019 nga qirat. Tarifat janë vendosur referuar VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.

Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Përlllogaritja e qirasë bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga bashkia me subjektet të cilat janë të interesuar të marrin me qira troje apo ndërtesa në pronësi të bashkisë.

Tarifa për dhënie me qira jepet si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njësia	Niveli tarifës
1	Qeraja e tregut lirë	Lekë/m ² /muaj	250
2	Tarifë dhënie me qira mujore për ndërtesat të rikonstruara	Lekë/m ² /muaj	300
3	Tarifë dhënie me qira mujore, ndërtesat të parikonstruara	Lekë/m ² /muaj	200
4	Tarifë për dhënie lejeër terrene sportive	Lekë/aktiviteti	50,000

Tabela 37. Tabela e tarifave për dhënie me qira

ii. **Të ardhurat nga kundravajtje administrative (Gjobat):**

Gjobat bazohen në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”: Bazuar në nenin 6.b, ”Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta”.

Bazuar në nenin 10, “Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë e maksimal. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte. Vlera e të ardhurave parashikuara nga gjoba është për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore, gjoba për kundravajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, dhe nga Inspektoriat VMK Territorit. IVMKT dhe Policia Bashkiake janë përgjegjëse për vjeljen e gjobave.

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016 parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë si më poshtë:

Emërtimi	V.2017 (000 lekë)	V.2018 (000 lekë)	V.2019 (000 lekë)
Gjoba IVMKT & Pol.Bashk.	3,000	2,550	2,601
TOTALI	3,000	2,550	2,601

Tabela 38. Të ardhurat nga burime të tjera të bashkisë për 2017-2019 (000/l.

iii. **Të ardhurat nga privatizimet;**

Baza ligjore për të ardhurat nga privatizimi është VKM nr.608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë, të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk disponon akte fitimi pronësie”, dhe VKM nr.614, datë 07.07.2015 “Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese, me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njëjsve të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të paisur me autorizim nga organet kompetente”.

- Tarifa e shërbimit administrativ 3000 lekë, për çdo aplikim. Të ardhurat nga privatizimi paguhen nga përfituesi i pronës.

A.2 Të ardhurat nga burimet qendrore;


B.	Burimet Qendrore	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
	Totali	566,830	504,422	517,407
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	281,182	289,617	298,306
B.2	Transferta Specifike	167,798	171,154	174,577
B.3	Transferta e Kushtëzuar	42,795	43,651	44,524
B.4	Fond Investimesh nga Buxheti i Shtetit (FZHR)	75,055	0	0

Tabela 39. Burimet qendrore për vitet 2017-2019 në (000 lekë)

Në të ardhurat nga burimet qendrore përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike dhe transfertat e kushtëzuara. Niveli i transfertës së pakushtëzuara, specike dhe të kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktohet çdo vit në ligjin e buxhetit të shtetit.

Për vitin 2017 nga burimet qendrore bashkia ka marrë 566,830 mijë lekë. Pjesën me të madhe

tek këto burime e zë transferta e pakushtëzuar (49.4 %).



Struktura e Burimeve qendrore për vitin 2017 në (000 lekë)

A.2.a Transferta e pakushtëzuar;

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet të njëjësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë për çdo njësi (që kap diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

Përveç ekualizimit të kostove që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mbli-dhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e pa-uajtshme të shitura nga personat juridikë.

Viti 2016, është viti i parë i aplikimit të formulës së re dhe është përdorur si një mekanizëm tranzitor që siguron që të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, qetë marrin minimalisht 85 % të transfertës që kanë marrë vitin e mëparshëm.

Bashkisë Lezhë për vitin 2017 i janë akorduar transfertë të pakushtëzuar 281,182 mijë lekë, për një popullsi prej 108,197 banorë sipas gjendjes civile, ku popullsia e Lezhës zënë 2.46 % të popullsisë së vendit.

Bashkia Lezhë ka përfituar transfertë 4.15 lekë për banorë të përhershëm.

Totali i transfertës së pakushtëzuar të alokuar për vitin 2017 për Bashkinë Lezhë është 281,182 mijë lekë, duke përbërë kështu 19.9 % të të ardhurave totale të bashkisë. Për 2018 kjo transfertë parashikohet të jetë 289,617 mijë lekë ose 20.5 % të të ardhurave totale të bashkisë, ndërsa për 2019 pritet të rritet në 298,931 mijë lekë ose 21.1% të të ardhurave të bashkisë.

Transferta e pakushtëzuar financon funksionet që janë transferuar në pushtetin vendor, ku fondi i investimeve në transfertën e pakushtëzuar për vitin 2017 zë 36.2 % ose 123,922 mijë lekë.

A.2.b Transferta specifike sipas funksioneve;

Arsimi parauniversitar.

Në transfertën specifike të vitit 2017, Bashkisë Lezhë i akordohen fonde për arsimin parauni-

versitar dhe parashkollor. Në këtë transfertë përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës shërbimi dhe edukatorë).

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Për arsimin parauniversitar për 2017 janë alokuar gjithsej 8,357 mijë lekë për paga dhe sigurime shoqërore; për 2018 ky fond është parashikuar në vlerën 8,524 mijë lekë, ndërsa në vitin 2019 kjo vlerë llogaritet në 8,695 mijë leke.

Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor.

Në transfertën specifike të vitit 2017, janë fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Fondi i alokuar për këtë funksion për 2017 është 95,447 mijë lekë, për 2018 është parashikuar në vlerën 97,356 mijë lekë, ndërsa në vitin 2019 kjo vlerë llogaritet në 99,303 mijë lekë.

Konvikti i Shkollës së Mesme Profesionale.

Në transfertën specifike të vitit 2017, janë fondet për personelin kujdestar dhe ndihmës të konviktit. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Fondi i alokuar për këtë funksion për 2017 është 9,137 mijë lekë, për 2018 është parashikuar në vlerën 9,320 mijë lekë, ndërsa në vitin 2019 kjo vlerë llogaritet në 9,506 mijë lekë.

Administrimi i Pyjeve.

Në transfertën specifike të vitit 2017, janë fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Fondi i alokuar për këtë funksion për 2017 është 4,153 mijë lekë, për 2018 është parashikuar në vlerën 4,236 mijë lekë, ndërsa në vitin 2019 kjo vlerë llogaritet në 4,321 mijë lekë.

Ujitja dhe Kullimi.

Në transfertën specifike të vitit 2017, janë fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Fondi i alokuar për këtë funksion për 2017 është 19,870 mijë lekë, për 2018 është parashikuar fondit në vlerën 20,267 mijë lekë, ndërsa në vitin 2019 kjo vlerë llogaritet në 20,673 mijë lekë.

Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri (PMNZSH).

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimit. Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Shuma e alokuar për vitin 2017 është 25,778 mijë lekë, ku numri i punonjësve në këtë sektor është 30 vetë, për 2018 është parashikuar fondit në vlerën 26,294 mijë lekë, ndërsa në vitin 2019 kjo vlerë është llogaritur në shumën 26,819 mijë lekë.

Rrugët Rurale

Në transfertën specifike të vitit 2017, janë fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Për këtë funksion për vitin 2017 janë akorduar 5.056 mijë lekë, për 2018 është parashikuar fondit në vlerën 5.157 mijë lekë, ndërsa në vitin 2019 kjo vlerë është në shumën 5.260 mijë lekë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve specifike do të bëhen në përputhje me kuadrin

ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Për funksionet e mësipërme transferta specifike në tre vitet paraqitet me një rritje 2 % çdo vit.

Nr.	Transferta Specifike/Funksionet	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Arsimi bazë dhe shërbimet mbështetëse	95,447	97,356	99,303
2	Arsimi i Mesëm	8,357	8,524	8,695
3	Konvikti	9,137	9,320	9,506
4	Administrimi i Pyjeve	4,153	4,236	4,321
5	Rrugët Rurale	5,056	5,157	5,260
6	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri (PMNZSH)	25,778	26,294	26,819
7	Ujitja dhe Kullimi	19,870	20,267	20,673
	TOTALI	167,798	171,154	174,577

A.2.c Fondi i Investimeve nga Buxheti i Shtetit (FZHR);

Bashkia për vitin 2017 ka përfituar fonde për investime nga Buxheti i Shtetit në vlerën 75,055 mijë lekë. Ky fond i përfituar do të aplikohet për financimin e projektit të rrugës nga Superstrada Gajush deri tek I.E.V.P Shënkoll me vlerë 41 milion lekë, për infrastrukturën e ujitjes (kanaleve të dyta) në zonën e Zadrimës dhe Kallmetit me vlerë 25 milion lekë dhe për blerjen e 1 eskavatori me vlerë 9,055 mijë lekë.

Projektet miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë i cili përcakton edhe masën e kontributit/bashkë-financimit nga njësitë e qeverisjes vendore.

A.2.d Transferta e Kushtëzuar;

Transferta e kushtëzuar për vitin 2017 përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e Shërbimit të Gjendjes Civile në vlerën 7,348 mijë lekë, ku duhet theksuar se ky fond i akorduar për vitin 2017 është më pak se nevojat për shumën 500 mijë lekë, për mbulimin e shpenzimeve të transportit të nxënësve dhe mësuesve, në vlerën 29,332 mijë lekë dhe për bursat e nxënësve të shkollës së mesme profesionale me vlerën 6,115 mijë lekë.

Nr	LLOJET E TE ARDHURAVE	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
D	Transferta e Kushtëzuar			
1	Gjendja Civile	7,348	8,025	8,186
2	Transporti i nxënësve dhe mësuesve	29,332	29,919	30,517
3	Bursat e nxënësve të Sh.M.Profesionale	6115	6,237	6,362

Tabela 41. Transferta e kushtëzuar për vitin 2017-2019 në (000 lekë).

III. Shpenzimet e Bashkisë për vitin 2017-2019;


Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2017 është 1,410,635 mijë lekë. Gjatë viteve 2017-2019, përmes këtyre shpenzimeve të planifikuara, bashkia synon të punojë duke iu përgjigjur detyrimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj.

Nr.Prog	Programet	Viti 2017 (000/l)
P.1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	366,760
P.2	Shërbimet Publike	279,587
P.3	Infrastruktura Rrugore dhe Transporti Publik	268,043
P.4	Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar	248,143
P.5	Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit	0
P.6	Strehimi dhe Shërbimet sociale	28,333
P.7	Kultura, Rinia Sportet, Turizmi	60,507
P.8	Mbrojtja dhe Siguria Publike	63,936
P.9	Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave	16,908
P.10	Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	68,418
	Fondi Rezervë	5,000
	Fondi i Kontigjencës	5,000
	TOTALI	1,410,635

Tabela 42. Shpenzimet totale të Bashkisë Lezhë sipas programeve buxhetore për vitin 2017 në mijë lekë.

Pjesa më e madhe e fondeve në vitin 2017 shkon për Programin Planifikim, Menaxhim, Administrim dhe Shërbimet Publike (48 %).

Më poshtë është paraqitur detajimi i buxhetit të programit sipas klasifikimit ekonomik dhe burimeve të financimit për vitin 2017.



		Sipas klasifikimit ekonomik					Sipas burimeve te financimit					000/leke
	Programet buxhetore	Paga & Sigurime	Operative	Transferta	Investime	Totali	Nga burimet e Veta	Transferta Pakushtezuar	Transferta Specifike	Donator	Transferta e Kushtëzuar	Totali
P1	Planifikim Manaxhim Administrim	263,511	93,038	8,427	1,784	366,760	268,148	91,264			7,348	366,760
P2	Shërbimet publike	50,513	184,074		45,000	279,587	210,414	69,173				279,587
P3	Infrastruktura rrugore dhe transporti publik	24,986	46,260	11,000	185,797	268,043	95,945	121,733	5,563		44,802	268,043
P4	Arsimi parashkollor & parauniversitar	160,089	73,163	6,115	8,776	248,143	72,261	23,166	117,269		35,447	248,143
P5	Planifikimi dhe Zhvill. Territorit					0						0
P6	Strehimi dhe Shërbimet sociale		8,834		19,499	28,333	27,933	400				28,333
P7	Kultura, Sportet, Turizmi	55,467	5,040			60,507	42,967	17,540				60,507
P8	Mbrojtja dhe siguria publike	47,395	16,541			63,936	29,595	7,615	26,726			63,936
P9	Mjedisi dhe Admin. Pyjeve e Kullotave	13,874	534		2,500	16,908	9,357	3,220	4,331			16,908
P10	Bujqësia dhe zhvillimi rural	21,775	12,564		34,079	68,418	9,730	4,568	54,120			68,418
	Fondi rezervë			5,000		5,000	3,000	2,000				5,000
	Fondi i Kontigjencës			5,000		5,000	3,000	2,000				5,000
	TOTAL I SHPENZIMEVE	637,610	440,048	35,542	297,435	1,410,635	772,350	342,679	208009	0	87597	1,410,635

P1. Planifikim, Manaxhim, Administrim;

